MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike

Përshkrimi i produktit

MARMOFIX Kratzputz Innen: Llaç akrilik i gatshëm për përdorim me kualitet të shkëlqyeshëm. Përmban agregate me granulacion special të thërmive dhe formon sipërfaqe dekorative me teksturë të vrazhdë.

- Elasticitet të lartë dhe lidhje të shkëlqyer për substratin
- Nuk ka nevojë për ngjyrosje të sipërfaqes
- Rezistencë ndaj bazave
- Mbrojtje nga plasaritjet, për dallim nga llaçet çimento gëlqerore

Përdorime të rekomanduara

MARMOFIX Kratzputz Innen mund të aplikohet në të gjitha llojet e materialeve ndërtimore si llaçe, beton, çimento, pllaka çimentoje, pllaka gipsi, etj.

Falë elasticitetit të lartë dhe ngjitjes së shkëlqyeshme në substrate të ndryshme, krijon sipërfaqe ideale për të gjitha hapësirat e jetesës.

KRATZPUTZ
Innen

...GARANTIERTE
QUALITÄT!

www.marmofix.ch

Marmofix DOOEL Chelopek, Brvenica
Address: 101 Str, No. 3, Chelopek, 1216
Tetovo, R. North Macedonia
Tel: +389 75 211 222

MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike

KRATZPUTZ
Innen

Karakteristika teknike

Rrëshirë	Kopolimer akrilik
Dendësia	1,80±0,03 gr/ml
Ngjitja	0.4 MPa (EN 1542)
Reaksioni ndaj zjarrit	Euroklasa C
Harxhimi	1.0mm 2,0kg/m2 1.5mm 2,4kg/m2 2.0mm 2,8kg/m2
Tharja	4-6 orë (23°C dhe 50% R.H.)
Nuancat	E disponueshme në ngjyrë të bardhë dhe qindra nuanca tjera bazuar në SISTEMIN E NGJYROSJES MARMOFIX (MARMOFIXTINTING SYSTEM (MTS)
VOC (Komponime të avullueshme organike)	Vlera kufitare për kategorinë e këtij produkti A/a është 30g/l (2010). Produkti përmban maksimum 29g/l.

Përgaditja e substratit dhe instruksione për aplikim

- **Përgaditja e substratit**
  Substrati duhet të jetë i pastër, i thatë dhe të mos përmbajë material defektiv dhe të ngjitur dobët për sipërfaqen si për shembull pluhur, yndyrë, kripë, etj. Sipërfaqet e reja dhe vjetra duhet të impregnohen me **VORANSTRICH VA-150 Grund**.
  Sipërfaqet me myshk dhe alga duhet të pastrohen/dezinfektohen para aplikimit të astarit.
- **Përgaditja dhe aplikimi**
  Metoda e aplikimit: Mistri çeliku
  Hollues: Ujë
  Hollimi: gatshëm për përdorim
  MARMOFIX Kratzputz Innen zakonisht aplikohet në një shtresë.

  Para përdorimit, llaçi duhet të përzihet me përzierës elektrik dore, dhe nëse është e nevojshme, duhet të hollohet me një sasi të vogël uji për të fituar konzistencë të mirë. Ngjyra e llaçit duhet të kontrollohet para përdorimit.
  MARMOFIX Kratzputz Innen aplikohet me mistri çeliku në trashësi të njejtë sa madhësia e kokrrës. Mund të strukturohet sipas temperaturës dhe lagështisë nga moment i aplikimit dhe për 15-20 minuta më pas. Pamja e fundit fitohet duke punuar me mistri plastike, me lëvizje horizontale, vertikale, ose rrethore varësisht nga paraqitja e sipërfaqes, derisa masa e aplikuar është e lagësht dhe e punueshme.
  Aplikimi nuk duhet të kryhet në temperatura mes +5°C dhe mbi +30°C. Gjatë dhe pas të gjitha aplikimeve, produktet duhet të mbrohen nga ndikimet atmosferike. Veglat duhet të lahen me ujë menjëherë pas përdorimit.

Përdorimi dhe ruajtja

Duhet të mbahet larg fëmijëve. Nuk nevojiten masa të veçanta gjatë punës me **MARMOFIX Kratzputz Innen**. Përdorni doreza mbrojtëse, syze mbrojtëse, dhe maskë. Në rast kontakti me sytë ose lëkurën, lani me sasi të bollshme të ujit, dhe sipas nevojës kërkoni ndihmë mjekësore.
Mbetjet e produktit duhet të hudhen sipas rregullave lokale. Nuk duhet të hudhet në kanalizime apo mjedis. Mbetja e thatë ose e ngurtësuar mund të hudhet si mbetje nga vendi i punëve ndërtimore ose si mbeturinë shtëpiake.
MARMOFIX Kratzputz Innen duhet të ruhet në temperatura mes +5 °C dhe +25 °C si dhe larg dritës së diellit. Në kovat origjinale të pahapura nën kushtet e lartëpërmendura, **MARMOFIX Kratzputz Innen** mund të ruhet për 24 muaj.

Paketimi

Kova 25 kg